



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 04.09.2019

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN PËR LEHTËSIMIN E TREGTISË DHE TË TRANSPORTIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR ME QASJE PROGRAMATIKE ME SHUMË FAZA”

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 04.09.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin z. Jurgis Çyrbja.

Në mbledhjen e komisionit, për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të komisionit, ishin të pranishëm dy zëvendësministrat e Ekonomisë dhe Financave: znj. Belinda Ikononi dhe z. Erjon Luçi.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje synon marrjen e një kredie në shumën prej 17 600 000 eurosh në mbështetje të projektit për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza. Ky projekt është pjesë e fazës së parë të një programi të përbashkët rajonal për vendet e Ballkanit Perëndimor, i cili synon të lehtësojë arritjen e qëllimit të qeverive përkatëse të këtyre vendeve për të ulur kostot e tregtisë dhe rritjen e efikasitetit të transportit përmes angazhimit afatgjatë, adaptiv dhe të vazhdueshëm.

Programi përfshin dy faza të cilat do të zbatohen për një periudhë pesë vjet secili.

Faza 1 mbulon 3 nga vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipërinë, Maqedoninë Veriore dhe Serbinë), të konsideruara gati për zbatim, dhe do të përfshijë një kombinim të investimeve, asistencës teknike dhe reformave rregullatore dhe institucionale.

Faza 2 e programit përfshin 3 vendet e tjera të rajonit: Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën dhe Malin e Zi.

Rezultatet e pritshme me realizimin e këtij projekti, të cilat janë të lidhura me objektivat e zhvillimit të tij gjatë fazës së parë, janë:

- reduktimi i kostove të tregtisë
- rritja e efikasitetit të transportit në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.

Projektligji është planifikuar për t'u implementuar gjatë periudhës 2019 – 2025.

III. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATOR

KRYETAR

JURGIS ÇYRBJA

ULSI MANJA